


Marjeta Shifrer
Helena Meshnjak

Fëmijët në Luftën e Dytë Botërore





Pyetja kyçe

A vuanin njëjtë fëmijët, pa e marrë parasysh anën në të cilën gjendeshin?

Tema

Ky modul flet për fëmijët në Luftën e Dytë Botërore, gjatë periudhës nga vitit 1939 deri në vitin 1945. Flet për fëmijët në lëvizjen partizane, fëmijët e mbrojtësve të atdheut, fëmijët në llogore dhe fëmijët korrierë/ushtarë. Burimet na tregojnë si kanë jetuar dhe vuajtur fëmijët gjatë kohës së luftës. Materiali është i përgatitur për fëmijët më të rritur se 14 vjeç. Kjo temë është zgjedhur sepse besojmë se është interesante për nxënësit. Tema është kontroverze sepse i paraqet fëmijët e të dyja anëve – partizanët dhe anën tjetër, e cila ka vendosur të bashkëpunojë me nazistët, ndërsa moduli e përfshinë tërë regjionin.

Qëllimet

Nxënësit do të fitojnë dituri për fëmijët në lëvizjen partizane, fëmijët në radhët e mbrojtësve të vendit, fëmijët në llogore dhe fëmijët korrierë/ushtarë. Burimet na tregojnë si kanë jetuar dhe vuajtur fëmijët gjatë kohës së luftës.

Rezultatet e mësimit

1. Nxënësit do të përfitojnë njohuri për jetën e përditshme të fëmijëve në Luftën e Dytë Botërore.
2. Do të kenë mundësi ta krahasojnë jetën dhe vuajtjet e fëmijëve gjatë kohës së Luftës së Dytë Botërore.
3. Do të fitojnë njohuri për fatin e fëmijëve në radhët e partizanëve, mbrojtësve të atdheut, fëmijët në llogore dhe fëmijët korrierë/ushtarë.
4. Do të njihen me aktivitetet luftarake nga perspektiva e të drejtave të njeriut.



Udhëzime për mësimdhënësin

Mësimdhënësi do t'ua lexojë hyrjen nxënësve dhe do t'ua paraqesë temën e orës. Punësoria ka dy faza – faza e parë është hyrje në punë grupore, ndërsa e dyta është prezantimi i rezultateve.

HAPI 1: Mësimdhënësi jep udhëzime për punë. Ai/ajo e sqaron shkurtimisht temën (fleta e parë e punës është për mësimdhënësin). Nxënësit ndahen në 4-5 grupe.

Grupi 1: Fëmijët partizanë

Grupi 2: Fëmijët në llogore

Grupi 3: Fëmijët ushtarë / korrierë

Grupi 4: Fëmijët në anën “tjetër” (në mbrojtësit e vendit)

HAPI 2: Mësimdhënësi i prezanton detyrat e punës në grupe. Nxënësit duhet të kenë dituri themelore për Luftën e Dytë Botërore. Nxënësit e analizojnë hartën e Jugosllavisë dhe përpiqen të përcaktojnë cili okupues cilën pjesë të vendit e ka marrë në Luftën e Dytë Botërore.

HAPI 3: Mësimdhënësi i parashtrohet pyetjet dhe i udhëheq nxënësit në punë ekipore:

Shkruani listën e gjërave që duhet t'i kenë fëmijët që të kenë fëmijëri të lumtur.

HAPI 4: Mësimdhënësi jep udhëzime për punë ekipore. Nxënësit i lexojnë burimet, përgatisin prezantime të shkurtra dhe zgjedhin detyra.

HAPI 5: Prezantim i shkurtër i punës në grupe.

HAPI 6: Përfundim, refleksion për temën (nxënësit me ndihmën e mësimdhënësit duhet të vijin te përfundimi i përbashkët – pa e marrë parasysh atë se për cilët fëmijë bëhet fjalë – të gjithë kanë vuajtur njëjtë, ndërsa mbi të gjithë fëmijët që kanë mbetur jetimë).

Mësimdhënësi tërheq vijë të drejtë në tabelë. Në njërin skaj të linjës shkruan që të gjithë fëmijët kanë vuajtur në mënyrë të barabartë, ndërsa në skajin tjetër që niveli i vuajtjes ka qenë i ndryshëm. Pastaj mësimdhënësi të gjithë nxënësve u shpërndanë letra vetngjitëse. Me ndihmën e njohurive të reja të fituara, nxënësit vendosin në cilën anë të linjës do ta ngjisin letrën e tyre. Secili nxënës gjithashtu e sqaron vendimin e tij ose saj...



90
minuta

HYRJE

Rritja gjatë kohës së luftës për shumë fëmijë nuk ka qenë përvojë e këndshme. Punëtorja “Fëmijët në luftë”, siç tregon edhe vet emri, flet për fëmijët të cilët kanë jetuar në hapësirën e ish Jugosllavisë gjatë kohës së Luftës së Dytë Botërore. Punëtorja është ndarë në pjesën hyrëse, punë në grupe dhe në fund, prezantimi i rezultateve të punës. Nxënësit në katër grupe duhet t'i analizojnë dhe vështrojnë fatet e fëmijëve partizanë të cilët janë dërguar në llogore, fëmijët të cilët kanë qenë korrierë dhe ushtarë, dhe fëmijët të cilët kanë qenë në anën unfërë ruëmijrëa ann tlnrëasn nsir a p hrt-97.9 (a) a lrt2.6(ë)

Burimi 4

Fëmijët e vjedhur

Fati i fëmijëve të prindërve të vrarë ose të dërguar në llogore e pastaj të bartur në Rajh te familjet gjermane ishte i vështirë. Baza për gjenocid gjatë kohës së Luftës së Dytë Botërore në Evropën e mesme ishte edhe instruksioni i fshehtë i Himlerit për zbatimin e aksioneve kundër partizanëve dhe banditëve të tjerë në Korushkën e Epërme dhe Shtajerskën e Poshtme, i lëshuar në 15 ekzemplarë më 25 korrik 1942. Në bazë të këtij instruksioni, njerëzit vriteshin pa hetime, digjeshin fshatrat, ndërsa shumë familje partizane u dëbuan.

Në Shtajerskën e Poshtme ishte qendra tubuese për dëbim në Celje, në shkollën e dikurshme të djemve, sot të njohur si Shkolla e Parë Fillore, ku u kryen dy dëbime, më 3 dhe 14 gusht 1942. Rreth 600 fëmijë të vegjël me forcë u morën nga nënat e tyre. Këta fëmijë kryesisht ishin nga familjet e partizanëve dhe familjet e të vrarëve në burgje. Fatet e tyre dallojnë, por të gjithë kaluan nëpër procedurën e njëjtë. Fëmijët u kontrolluan për përcaktimin e përkatësisë racore (etnike), pastaj u dërguan në llogorin Fronlajten, në veri të Gracit, ndërsa nga andej u dërguan nëpër kampe të ndryshme të përqendrimit anekënd Gjermanisë, për riedukim. Veçanërisht iu kushtua kujdes fëmijëve të grabitur, të cilët në të shumtën e rasteve përfundonin si të adoptuar në familjet naziste. Organizata me emër "Lebensborn" kujdesej për foshnjat. Qëllimi i tyre kryesor ishte riedukimi i fëmijëve të racës së pastër të përkatësisë tjetër etnike, për shkak të krijimit të racës së pastër ariane dhe rritjes së shpejtë të numrit të foshnjave të gjermanët. Identiteti i vërtetë i fëmijëve të grabitur fshihej, kështu që shumë fëmijë asnjëherë nuk janë gjetur.

Këta dy aksione të gushtit të vitit 1942, kur fëmijët u morën me dhunë nga nënat e tyre, nuk ishin edhe të fundit në Celje. Nazistët gjithashtu kryen ndarje racore dhe nacionale në dhjetor të vitit 1944 dhe janar 1945. Kësaj radhe fëmijët u dërguan në Koblenc dhe Burgenland.

Pas çlirimit, aleatët e UNRRE – Administratës për Ndihmë dhe Rehabilitim të Kombeve të Bashkuara i kërkonin fëmijët e grabitur, ndërsa u ndihmonin edhe oficerët e Misionit të Veçantë Ushtarak të Jugosllavisë në Paris. Sllovenia organizoi riadhesime të veçanta që pranoi 4.150 fëmijë të grabitur të moshës deri 16 vjeç, në periudhën nga 1 korriku deri më 20 shtatori 1945. Megjithatë, shumë fëmijë të grabitur nuk janë gjetur asnjëherë.

Mikuž Metod (1960). *Pregled zgodovine NOB-a v Sloveniji*. I knjiga. Ljubljana, strp. 62, 187.

PYETJE:

1. Kush ishin fëmijët e vjedhur?
2. Nga cili vend vinin shumica e fëmijëve të vjedhur?
3. Çka do të thoshte "Lebensborn"?
4. A u kthyen këta fëmijë në shtëpi pas luftës? Pse nuk u kthyen të gjithë?

Burimi 5

Rrëfimi i Jozhica Komerçkit – fëmijëria e grabitur

Jozhica Komerçki nga Petrovçi, lindur me mbiemrin Jurkoshek në Podgoricë – Vrh mbi Llashko, kujton ngjarjet e tmerrshme të fëmijërisë së vjedhur:

"Kur erdhën të na arrestojnë, unë kisha mezi 11 vite, motra ime Marija 17, ndërsa vëllai im Konrad 13 vite. Gjithashtu e dëbuan nënën tonë dhe motrën njëzetvjeçare Tonçkën. Ata asnjëherë nuk u kthyen nga Aushvici. Babai ynë u burgos në korrik të vitit 1942. Ai u pushkatua më 15 gusht, ditën e njëjtë kur ne u dërguam në qendrën e tubimit në Celje. Gjithashtu i morën edhe shtatë fëmijët Grançer, dhe fëmijët e familjes Llapov, Dezhelak dhe të tjerë. Qyteti im quhej Vrh mbi Llashko.

Së pari na dërguan në kampin për transit, karantinë, në vendin Mur pranë Gracit. Edhe pse ishte ftohtë, duhej që çdo mëngjes të ushtrojmë në brekë dhe këmisha krahëshkurtra. Duhej të vrapojmë pranë pyjeve të afërta. Më vonë u shpërndamë në gjashtë llogore fëmijërore. Mua më dërguan në Salldenburg pranë Tittlingut, Bauernwaldit në Bavari".

Jozhica mbijetoi sepse ishte mësuar me punë të rëndë në shtëpi, në fermë. Luftën e pranoi si diçka që duhej të ndodhë dhe ajo vetë këtu nuk kishte mundësi të ndryshojë asgjë. E mban mend edhe Villin gjashtëmujor, të grabiturin nga Shentlenarti, i cili ishte adoptuar, dhe të gjithë ngatërresën që u krijua me mbarimin e luftës.

Bjellorusët fëmijëve të grabitur u thoshin të mos kthehen prapa te komunistët slovenë. Vëllai i saj, i cili ishte ushtar gjerman, para çlirimit e shkroi kërkesën që fëmijët të kthehen nëpër shtëpi. Por nuk kishin mundësi të kthehen në shtëpinë e shkatërruar. Vëllai shkoi të jetojë me tezen e tyre në Rimske Toplice, ndërsa Jozhica dhe motra e saj shkuan të jetojnë në fshatin partizan Brodnice.

http://www.dnevnik.si/tiskane_izdaje/nedeljski/333577 (3. 2. 2012)

PYETJE:

Cili ishte fati i Jozhica Komerçkit?

Burimi 6

KADETËT DHE PIONIERËT NGA DELNICA – Kroaci (Shkurt, 1944)



Fototeka na Gorewskiot muzej, Kraw

PYETJE:

1. Çka kuptoni nga kjo foto?
2. Çka tjetër dëshironi të dini?

Burimi 1

Fëmijët slovenë në kampin e përqendrimit

Stanislava Završnik, lindi më 3 mars 1933, në familjen e Berlec, në fshatin Loke në ultësirën e Tuhinjit. Jetonte në fshat me babanë, nënën, vëllanë më të madh dhe katër motrat më të vogla. Kur gjermanët e okupuan vendin tonë, Stanislava kishte vetëm 8 vite. Babai i saj, Ivani, ishte organizatori i parë i frontit çlirimtar në ultësirën e Tuhinjit dhe iu bashkëngjiti partizanëve në vitin 1941. Për këtë arsye familja Berlec ishte njëra nga familjet më të urryera dhe më të kërkuara të Gjermanët. Në vitin 1942 nëna iu bashkëngjiti brigadës (partizane) dhe fëmijët u lanë vetë. Disa muaj fëmijët nga mosha tre mujore deri në moshën 11 vjeçe fshiheshin në mal, te farefisi, por askush nuk kishte mundësi t'u ndihmojë. Në korrik të vitit 1942 gjermanët i kapën dhe i dërguan në kampin e përqendrimit të fëmijëve Seligenporten, ku tanimë ishin internuar rreth 100 fëmijë slovenë pa prindër ose të rritur të tjerë.

Në fillim të gjithë ishin bashkë, më vonë fëmijët u ndanë sipas rendit alfabetik. Në fund të majit 1943 fëmijët gjithashtu u ndanë sipas moshës dhe gjinisë. Vëllai më i madh Millani u transferua në llogoren Kastl, motra më e vogël Johana në Lajpcig, Ana në Majburg, Justina në Naustift, ndërsa Marija dhe Stanislava u bartën në Saldenburg. Në llogoret e përqendrimit fëmijët e kishin të ndaluar të flasin në gjuhën slovene, ishin të detyruar të ndjekin arsimim të rreptë nazist. Në fund të vitit 1944 kur gjermanët filluan ta humbin forcën, disa llogore fëmijësh u braktisën dhe kështu motrat Berlec bashkërisht e gjetën lirinë në kampin Saldenburg. Në korrik të vitit 1945 të gjithë erdhën në shtëpi, ku i gjetën prindërit e tyre.

http://www.muzeji-radovljica.si/_arhiva/mestni/zgibanka.pdf

Burimi 4

Fëmijët nga serbë në kampin e përqendrimit

Kujtime: "Për likuidimin e fëmijëve e di atë që kishte shumë fëmijë në kamp, dhe një komision i caktuar mjekësh i përbërë nga aspiranti Ilija Bukovac dhe dr. Buki Kunorti, të cilët kishin për detyrë t'i mbledhin fëmijët e shëndoshë të cilët u dërguan në Zagreb, Sisak, Jasku dhe Feričance. Gjatë kontrollit, policia gjeti 63 fëmijë të sëmurë dhe propozoi që duhet të likuidohen. Drejtuesi i kampit Mile Oreshković më urdhëroi mua dhe Grubishiqit ta kryejmë likuidimin e fëmijëve të përmendur. Janko Grubishiq propozoi që të mbyten por kur hyri në mesin e fëmijëve, fëmijët e sulmuan, dhe atëherë bashkërisht vendosëm që fëmijët të likuidohen me ndihmën e gazit. Me këtë rast u likuiduan të gjithë 63 fëmijët të cilët gjendeshin në një dhomë".

Ante Vrbani, ustaški oficir i član uprave logora Stara Gradiška na suđenju 14.01.1948 .. "Borba" 15.01.1948

Burimi 2

Fati i fëmijëve në kampet italiane të përqendrimit

Në kohën e përndjekjes në regjionin e Lubjanës, okupatorët italianë i burgosnin slovenët në burgjet e Lubjanës dhe Italisë. U takuan përfaqësuesit e lëvizjes së rezistencës nga zonat okupuese italiane – nga Sllovenia, Istra, Dalmacia, Mali i Zi dhe Shqipëria e Kosova. Të burgosurit jetonin në kushte të tmerrshme. Gratë me fëmijë të vegjël dhe shtatzëna kishin shumë probleme, sepse qelitë e burgut ishin të ftohta, të ndyta, plotë me morra dhe insekte. Foshnjat e porsalindura vdisnin nga sëmundjet. Në mesin e të burgosurve kishte edhe mjekë të cilët përpiqeshin t'i shpëtojnë gratë, fëmijët dhe foshnjat. Pas kapitullimit të Italisë në vitin 1943, në kampe u organizua arsimimi për fëmijë.

Cita Lovren i Bole. 1988. Prekomorke. Ljubljana. str. 22 – 174.

Burimi 3

Nënat dhe fëmijët në kampin e përqendrimit



Cita Lovrenčić Bole. 1988. Prekomorke. Ljubljana. P. 22 – 174

PYETJE

1. Çka shihni në këtë fotografi?
2. Çka ju flet kjo fotografi?
3. Çka tjetër dëshironi të dini?

Burimi 5

Fati i fëmijëve serbë në kampet e përqendrimit

...Në fund të nëntorit të vitit 1942 na vizitoi një komision dhe menjëherë pas kësaj na mblodhën dhe na dërguan në Zagreb. Që në stacionin hekurudhor na prit një befasi e këndshme sepse na prit një masë qytetarësh që shprehte ngushëllime dhe miqësi. Na hidhnin bukë dhe kartolina me adresat e tyre. Posaçërisht nga preku qarja e disa qytetarëve të cilët na shikonin, e veçanërisht gratë. Na dhanë pak veshje dhe mbathje... Së pari ishim në Entin e Shurdhmemecëve në Zagreb, Ilica 83, e më pas në shtëpinë në Vllashka 37. Ajo ishte rezidenca e ipeshkvisë, pranë katedrales... Të dielave na dërgonin në kishën katolike. Në Zagreb kushtet e jetesës ishin shumë më të mira se ata në kamp. Këtu na dhanë edhe emra të tjerë: Ivan, Mate, Joco, Josip etj. Edhe pse isha fëmijë, më kujtohet se kjo, mua dhe të tjerëve na erdhi shumë keq... Pas çlirimit erdha në vendin tim. Më goditi rëndë fakti që prej rreth 600 shokëve të mi nga kampi, një numër shumë i vogël u kthyen në vendlindje. Të tjerëve u humbi çdo gjurmë nëpër kapet fashiste".

Žarko Vujičić, *Velika ofanziva na Kozaru 1942. I njene posljedice*, Banja Luka 2004, str. 169-175.

Burimi 6

Fëmijët me Yllin e Dautit



<http://www.jusp-jasenovac.hr/Default.aspx?sid=5478> (9. 5. 2013)
Antisemitizam Holokaust Antifašizam, Ognjen Kraus (ur.), Židovska općina, Zagreb, 1996, str. 92.)

PYETJE:

1. Shikoje fotografinë dhe burimin 6 dhe përshkruaje.
2. Çka është ngjitur në kapotën e vajzës?
3. Çfarë domethënie ka?

KRAHASIMI		
	VETI TË PËRBASHKËTA	DALLIME
FËMIJËT SLLOVENË		
FËMIJËT KROATË		
FËMIJËT BOSNIË		

Burimi 1**Fëmijët korrierë (Rrëfim nga Shtefan Matek)**

Korrierët në Luftën Nacional Çlirimtare kishin detyra të vështira dhe të përgjegjshme. Vazhdimisht ishin në rrugë dhe në rrezik. Më lejoni të përshkruaj një pjesë të detyrave të mia si korrier. Udhëtimi më zgjaste 3 orë në një drejtim, dhe tre orë gjatë kthimit, me ngarkesë të rëndë në supet e mia, shpesh me pako, municion dhe bomba dore. Isha i detyruar të jem mjaft i kujdesshëm. Thujse nuk kisha kohë për pushim sepse duheshe të kem kujdes. Nuk duhej të dukemi brenda ditës. Nëse binte shi, isha i lagur derisa shiu nuk pushonte dhe teshat thaheshin në trupin tim.

Çdo të ditën natë, kur nuk isha korrier, shpërndaja postën, libra dhe gazeta.

Njëherë, përdërisa kthehesha në shtëpi nga rruga e zakonshme, isha aq i lodhur sa që flija duke ecur. Bredhja nëpër pyll gjithë natën. Rastësisht u ngatërrova në një rrënjë dhe kjo më zgjoi, por menjëherë sërish më zuri gjumi, duke qëndruar në këmbë. Kalova nëpër përroskë dhe duhej të bëj hapa më të mëdhenj. Isha shumë i lodhur që të shoh kur kam hyrë në ujë, u rrëzova dhe dola në anën tjetër. Në atë moment krisi pushka mbi kokën time. Në momentin e parë mendova se më sulmuan, por pastaj kuptova që kishte krisur pushka ime kur u rrëzova në ujë".


Burgar, M. (1972). Torbica partizanskega kurirja. asopis Na a skupnost (Ljubljana), letnik 13, t. 4.

Pridobljeno na spletni strani, (7. 8. 2012):

<http://www.dlib.si/details/URN:NBN:SI:DOC-N4BQV50C/?query=%27keywords%3dkurir%27&pageSize=25>

**Burimi 2**
Korrierët

Fototeka
Gorenjskega
muzeja u
Kranju

Burimi 3
Korrierët e kuvendit

Fototeka
Gorenjskega
muzeja u
Kranju

Burimi 4**Fëmijët korrierë – ushtarë në Maqedoni**

Fana Petra Kočovska – Cvetković (1927-2004)

Ishte anëtare e Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë që nga viti 1943 dhe bashkëpunonte me Frontin Jugosllav në Maqedoni që nga viti 1941. Aksioni i saj më mbresëlënës ishte kur kishte vetëm 17 vjet, kur bashkë me bashkëluftëtarët vullnetarë kreu sulm dhe e paaftësoi mekanikën e xeherores së Zletovës. Ky grup ishte përgjegjës që ta shkatërrojë mekanikën dhe ta paaftësojë punën e xeherores, ta shkatërrojë bazën e armikut të vendosur atje. Ata patën sukses. Para kësaj, Fana ishte në rrugëtim njëzetditor nga Kozhufi deri në Kozjak, nëpër borë të lartë dhe ftohtë. Shumë luftëtarë më të moshuar dhe më me përvojë ngecnin ose tërhiqeshin nga misioni, por vajza e re qëndroi dhe u bë shembull për të tjerët.

IBE SHERIF PALIKUQI

E fitoi mirënjohjen në moshën 15 vjeçare – u pranua në Lidhjen e Komunistëve të Rinj të Jugosllavisë, fazë mes rinisë dhe anëtarëve fuqplotë të komunistëve – për shkak të aktit të mbrojtjes së batalionit kur e goditi predha. U plagos rëndë, por shpejt u rimëkëmb dhe u kthye në vendin e saj. Lu kthye veprimtarisë ilegale në vendlindjen e saj në Dibër. Shqiptarja e re e ndihmoi revolucionin dhe fitoren.

PYETJE:

1. Çfarë pune bënin korrierët?
2. Përshkruaj korrierët në fotografi.
3. A ka diçka të pazakonshme për ta?
4. Çfarë pune bënin fëmijët?
5. Pse ishte puna e korrierëve ishte e vështirë dhe e përgjegjshme?

Materialet janë marrë nga libri Heroine Jugosllavije, Spektr, Zagreb, 1980 (abstrakt)

Burimi 1

Tërheqja e Mbrojtësve të Vendit dhe ustashëve, bashkë me familjet e tyre

Në pranverë të vitit 1945, pasi që ushtarët gjermanë e lëshuan zonën, jugosllavët e frikuar kaluan në Austri dhe Itali. Mes tyre ishin edhe Mbrojtësit e Vendit slovenë, çetnikët malazezë dhe hercegovas dhe shumë mbrojtës kroatë dhe ustashë. Kishte shumë familje dhe individë që kishin kryer krime lufte, por gjithashtu dhe shumë familje të zakonshme dhe individë që iknin nga fati i tmerrshëm. Rruga i çonte drejt ultësirës së Mislinjës, Dravës dhe Mezhiçës në Austri, prej nga shpesh i kthenin mbrapsht. Me mijëra njerëz i përfunduan jetët e tyre në xeheroret e braktisura, istikamet e tankeve, pyjet rreth Koçevjes, etj. Fëmijët ishin riedukuar, ngjashëm si në kapet gjermane të përqendrimit disa vite më parë. Qendrat më të mëdha për njerëzit e anës “tjetër” ishin në Vetinje, Teharju dhe Koçevje Rog, ndërsa për fëmijët ishte Petriček në Celje. Qendrat e tjera ishin në Ormozh, Ptuj dhe në vendet tjera anekënd Sllovenisë. Shumica ishin të vendosur në kazermat e vjetra, vilat e lëna pas dore dhe në objektet e vjetra të hotelarisë, siç është Petriček në Celje. Qendrat ishin plot refugjatë, ushtarë dhe familje të tyre, civilë, gra, vajza, fëmijë dhe pleq.

Tolstoj N. Klepec M. Kovač T. 1980. Trilogija Vetrinje – Teharje – Rog. Maribor. str. 13., 27.

Burimi 2

Njerëzit e dërguar në ekzekutim

Komunistët e shkatërruan pjesën e murit prapa vilës, në mënyrë që gjatë natës të kishin mundësi t'i kalojnë grupet e njerëzve nëpër atë kalim. I çonin nëpërmjet fushës deri te vendi i ekzekutimit, duke e anashkaluar në këtë mënyrë rrugën kryesore. Fshatarët dhe njerëzit e tjerë në Teharju ishin nën përshtypjen e tmerrshme të ngjarjeve të qershorit dhe korrikut të vitit 1945, bile edhe disa vite pas luftës. Njerëzit piskatnin, bërtisnin, kërkonin ndihmë, shfrynin, qanin, mitralozat krisnin ndërsa bombat eksplodonin. Edhe sot e kësaj dite njerëzit nuk guxojnë të flasin për atë sepse frikohen nga hakmarrja e komunistëve”.

Tolstoj N. Klepec M. Kovač T. 1980. Trilogija Vetrinje – Teharje – Rog. Maribor. P. 108.

Burimi 3

Kthimi i Mbrojtësve të Vendit nga Koroshka në Kranj, 30.05.1945



Fototeka Gorenjskega muzeja u Kranju

PYETJE:

1. Pse disa njerëz vendosin të iknin nga Jugosllavia pas luftës?
 2. Çka ndodhi me fëmijët e Mbrojtësve të Vendit?
- Përkthyer fotografinë anash – kush është në të, kur është bërë...?

Burimi 4

Jeta e përditshme në eksod

"Dita e parë në eksod ishte si çdo ditë tjetër e zakonshme, kur jam në gjumë të thellë dhe asgjë nuk mund të më zgjojë, as kërcëllima e rrotave të vjetra as dridhja e karrocës. Mirupafshim Lubjanë. Mirupafshim miq dhe shokë të shkollës. Jam tepër i lodhur të mendoj për ju. Vetëm dëshiroj të fle.

Përderisa flija, një grup i madh i refugjatëve erdhi deri te Drava dhe e kaloi kufirin jugosllavo-austriak. Ishin rreth 10.000 gjermanë, 13.000 sllovenë, 4.000 serbë dhe 4.000 rusë. Dita i afroheshe natës. Lugina pranë Vetrinjes e humbi pamjen e saj paraprake. Si kërpudha pas shiut shfaqeshit shatorët, kuajt, kafshët e tjera dhe njerëzit. Zjarret bënë dritë në gjysmë errësirë. Mrekulli e rrejtshme. Dëgjova piskamë fëmije para shatorit tonë. "Ndihe, ndihe, Janez! Janez!". Çka i ka ndodhur Janezit? E kapa vajzën e vogël dhe e shkunda. Më tha nëpër lot se Janezi shkoi te ura përtej lumit e cila ishte përplot mina. Janezi kishte bërë disa hapa kur kishte eksploduar diçka. Trupi i Janezit fluturoi në ajër dhe rra në bregun e lumit. "E kotë, çdo shpresë është e kotë!" Njerëzit vetëm qëndronin atje, një njeri e hoqi nga koka kapelën e vet dhe me nervozë e rrotullonte në duart e veta, ndërsa dy infermiere e mbanin nënën e Janezit. Ajo as qante as bërtiste. E larguan nga trupi i vdekur i djalit të saj.

Të gjithë e dinin që kthehemi në Jugosllavi, bile edhe unë, fëmijë i moshës 11 vjeçare. Por ku shkonim, nuk kishim mundësi të parashikojmë as në ëndrrat më të çmendura. Partizanët të cilët kryenin hetime personale, ishin në mesin e të zënëve rob. Na morën çdo gjë që ishte me vlerë. Partizanët ishin të rinj, thuajse fëmijë. Njëri prej tyre kishte ndoshta 12-13 vjet. U ul dhe pinte duhan.

Njerëzit ishin të dërmuar tej mase që të ndjejnë dhembje. As civilët nuk ishin ndryshe. Gratë binin në pluhurin e rrugës për në Teharje. Fëmijët ishin më të fortë. Të vegjlit i mbanin në krahët e nënave, ndërsa fëmijët më të mëdhenj, si unë, ecnin duke mbajtur ngarkesë të vogël me trupat e tyre. Largësia mes Celjes dhe Teharjes ishte nja 10 kilometra. Por neve na duhej si përjetësi. Ecnim me forcën e fundit, si qen të rrahur, deri në vendin ku duhet të mbërrinim."

Ott, Ivan (2008). *Otroci s Petrička – ukradeno otroštvo*.
Celje: Mohorjeva družba, p. 35, 36, 69, 79, 112, 147,
194, 197.)

Burimi 5

Fëmijë me uniforma të ustashëve (këta janë fëmijë jetimë, prindërit e të cilëve i kanë vrarë ustashët, ndërsa atyre u kanë vendosur kapela ustashësh)



Mihovilović, Đ., Smreka, J. (2006). *O poimeničnom popisu žrtava Jasenovac prema do sada prikupljenim i provjerenim podatcima. Spomen područje Jasenovac*, ur. Tea Benčić Rimay, str. 219

"Bëhet fjalë për fëmijë serbë të cilët ustashët i ndanë nga prindërit në vitin 1942. Familjet e fëmijëve nga fotografia një pjesë janë vrarë në kampin Jasenovac, ndërsa pjesa tjetër është dëbuar në Gjermani në punë të detyrueshme në fabrikat gjermane. Fëmijët sipas urdhrat të prijës të ustashëve Vjekoslav Maks Luburiq janë veshur me uniforma ustashësh, edhe pse ustashët ishin përgjegjës për vuajtjet e tyre dhe të prindërve të tyre".

(Dr. sc. Robert Skenderovi (Hrvatski institut za povijest), radionica "Stradanja ena i djece u logoru Jasenovac", Zagreb, 2007.

Burimi 6

Dërgimi i njerëzve në kampet e përqendrimit

"Kur fëmijët më të rinj u morën nga prindërit dhe u dëbuan ndërsa nënat tona u rrahën me pushka, këtu kishte shumë të qara dhe piskame. Babai im lutej dhe shikonte prapa lulishtes dhe grilave si nëna ime më mbante fort mua dhe vëllanë tim më të vogël. Fëmijët i hipën në autobus, ku duhej të këndojmë këngë partizane. Unë e di që nëna ime qante edhe më shumë sesa nata paraprake, sepse pa dyshim ndjente që do të vritej. Në ditën e nesërme, në orën 5 të mëngjesit u dërgua bashkë me një grua së cilës gjithashtu i kishin marrë tre fëmijë. Në atë kohë, babanë e dërguan në barakë; kur kërkoi ta shihte gruan e tij, një grua i kishte thënë se atë tanimë e kanë marrë, si edhe shumë të tjera".

Tolstoj N. Klepec M. Kovač T. 1980. *Trilogija Vetrinje – Teharje – Rog*.
Maribor. P. 99)

PYETJE:

Çka ndodhi me familjet e Mbrojtësve të Vendlit të kapura dhe të kthyer pas luftës?

PYETJE:

1. Shikojeni fotografinë në burimin 5 dhe lexojeni sqarimin. Pastaj lexojeni burimin 6.
2. Krahasojni të dy burimet – përpiku të përcaktosh ngjashmëri në riedukimin e fëmijëve që janë përmendur në të dyja burimet.